





EDUKIMI MJEDISOR



JANUAR 2026

Edukimi mjedisor i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Ai është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë qarkulluese. Nxënësit përfshihen në mbrojtjen e natyrës dhe njëkohësisht e duan edhe më shumë atë.

"Edukimi mjedisor rrit njohuritë, aftësitë dhe ndërgjegjësimin për mjedisin, duke nxitur vendimmarrje dhe veprime të përgjegjshme."

UNESCO

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në të 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjedisve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit



Përmes këtij manuali mujor Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura paraqet aktivitetet e zhvilluara nga 12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin dhe atyre që ndodhen pranë ZM-ve apo në zonat rurale, përgjatë muajit janar 2026.

Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjejeografike.

Nxënës të përfshirë 731

36 Shkolla të përfshira

Specialistë të angazhuar 24

36 Mësues të përfshirë

Orë mjedisore të realizuara 36



“EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



17–18 Janar 2026, Censusi i shpendëve ujqor dimëruës
Shpendët ujqor janë indikatorë të rëndësishëm të shëndetit të ekosistemeve natyrore. Specialistët e AdZM Shkodër, së bashku me studentë dhe natyralistë, zhvilluan aktivitetin e censimit në RNM Liqeni i Shkodrës dhe PUTM Lumi Buna–Velipojë, duke i njohur pjesëmarrësit me mënyrën e realizimit të këtij procesi dhe rëndësinë e monitorimit të biodiversitetit.

26 janar 2026, Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

Edukimi mjedisor është çelësi për të ndërtuar një shoqëri të ndërgjegjshme dhe të përgjegjshme ndaj natyrës. Specialistët e AdZM Shkodër zhvilluan një orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare “Hot i Ri”, ku nxënësit, përmes aktiviteteve kreative dhe bashkëbisedimeve, u njohën me rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe rolin e tyre në ruajtjen e tij.

27 janar 2026, orë mjesdore

Specialistët e AdZM Shkodër, në bashkëpunim me shoqatën “Cukali” dhe nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Gjergj Vat Martini”, organizuan mbjelljen e fidanëve të pishës në zonën e Vilunit, pjesë e Peizazhi i Mbrojtur Lumi Buna – Velipojë, me rastin e Ditës Kombëtare të Shërbimit Pyjor dhe 103-vjetorit të tij. Nxënësit u angazhuan drejtpërdrejt në procesin e mbjelljes, duke mësuar mbi rëndësinë e pyjeve dhe rolin që secili mund të ketë në mbrojtjen dhe pasurimin e mjedisit.

“EDUKIMI MJEDISOR”, GJIROKASTËR



16 janar 2026, orë mjedisore – PK “Bredhi i Hotovës–Dangëlli”

Në kuadër të aktiviteteve të edukimit mjedisor, specialistët e AdZM Gjirokastër zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së tretë të shkollës 9-vjeçare Shkolla 9-vjeçare “KamberBënja” në Këlcyrë. Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me vlerat natyrore dhe biodiversitetin e Parku Kombëtar “Bredhi i Hotovës–Dangëlli”, si dhe me rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe ruajtjes së habitateve natyrore. Ora mjedisore shërbeu për të nxitur dashurinë dhe respektin ndaj natyrës që në moshë të hershme.

22 janar 2026, mbrojtja e kafshëve

Specialistët e AdZM Gjirokastër zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së dytë të shkollës 9-vjeçare vjeçare “Koto Hoxhi”. Gjatë kësaj ore, nxënësit u informuan mbi rëndësinë e mbrojtjes së kafshëve dhe zonave të mbrojtura, duke theksuar rolin e tyre në ruajtjen e ekuilibrit natyror. Aktiviteti kontribuoi në rritjen e ndërgjegjësimit për ruajtjen e natyrës dhe respektin ndaj faunës..

26 janar 2026, Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

Në kuadër të Ditës së Edukimit Mjedisor, në shkollën 9-vjeçare "Koto Hoxhi" u zhvillua një orë mjedisore me nxënësit e klasës së katërt.

Gjatë aktivitetit u diskutua mbi rëndësinë e ruajtjes së natyrës, mbrojtjen e burimeve natyrore, riciklimin dhe ndikimin e ndotjes në jetën e përditshme. Përmes diskutimeve ndërvepruese, nxënësit shprehën mendimet dhe idetë e tyre për një mjedis më të pastër, duke forcuar përgjegjësinë individuale dhe kolektive ndaj mjedisit.

27 janar 2026, Dita e Shërbimit Pyjor

Me rastin e Ditës së Shërbimit Pyjor, specialistët e AdZM Gjirokastrë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së pestë të shkollës 9-vjeçare "Nonda Bulka" në Përmet. Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me rëndësinë e pyjeve dhe rolin e tyre në ruajtjen e ekuilibrit natyror. Për ta bërë orën më tërheqëse dhe kreative, fëmijët realizuan një aktivitet artistik duke krijuar tablo me degë pemësh të mbledhura në natyrë, si simbol i lidhjes së tyre me mjedisin.

“EDUKIMI MJEDISOR”, DIBËR



14 janar 2026, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Dibër zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Kurt Cakoni” në Baz.Përmes një aktiviteti krijues me temë “Pema Dimërore”, nxënësit realizuan punime artistike duke paraqitur elemente karakteristike të stinës së dimrit, si reshjet e borës dhe bora mbi degë. Aktiviteti synoi të nxisë imagjinatën, kreativitetin dhe dashurinë për natyrën, duke i ndihmuar nxënësit të njohin më mirë veçoritë e kësaj stine.

20 janar 2026, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Dibër zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Karicë”.Gjatë aktivitetit me temë “Pelikani Kaçurrel”, nxënësit u njohën me këtë specie të rrallë dhe të mbrojtur, habitatin ku jeton dhe rreziqet që e kërcënojnë. Përmes vizatimeve dhe diskutimeve, ata rritën ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e mbrojtjes së biodiversitetit dhe ruajtjes së specieve të rralla.

26 janar 2026, orë mjedisore

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Edukimit Mjedisor, specialistët e AdZM Dibër në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare “Irfan Hajrullai” zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit. Ata u njohën me rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, mënyrat konkrete për ta ruajtur atë dhe domosdoshmërinë e kategorizimit të mbetjeve. Aktiviteti përcolli mesazhin e bashkëpunimit dhe angazhimit për një të ardhme më të gjelbër.

orë mjedisore ndërgjegjësim edukim mjedisor



27 janar 2026, orë mjesore

Specialistët e AdZM Dibër në kuadër të kësaj dite zhvilluan një orë mjesore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Selim Alliu”.Përmes punës në grup dhe ndërtimit të një maketi simbolik, nxënësit u njohën me rëndësinë e pyjeve dhe domosdoshmërinë e mbrojtjes së tyre. Krahasimi i mjedisit të dëmtuar me atë të shëndetshëm shërbeu si një mesazh i qartë ndërgjegjësues për ruajtjen e pyjeve dhe natyrës.

“EDUKIMI MJEDISOR”, BERAT



26 janar 2026, Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

Specialistët e AdZM Berat organizuan një orë mjedisore në Shkollën 9-vjeçare Vodice në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Edukimit Mjedisor. Gjatë aktivitetit, nxënësit u informuan për ndotjen e mjedisit nga plastika dhe për ndikimet e saj negative mbi shëndetin e njeriut, duke theksuar rëndësinë e zvogëlimit dhe riciklimit të plastikës.

edukim mjedisor zona të mbrojtura

biodiversitet



“EDUKIMI MJEDISOR”, LEZHË



26 janar 2026, Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

Në kuadër të Ditës Botërore të Edukimit Mjedisor, specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës VII në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Karl Gega”. Gjatë aktivitetit u trajtua rëndësia e edukimit mjedisor dhe roli i zonave të mbrojtura, me fokus te Laguna e Patokut. Aktiviteti u zhvillua në mënyrë ndërvepruese përmes pyetjeve dhe quiz-eve, duke nxitur pjesëmarrjen aktive të nxënësve dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e mjedisit.



edukim mjedisor zona të mbrojtura

orë mjedisore

“EDUKIMI MJEDISOR”, DURRËS



14 janar 2026, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës VI të shkollës 9-vjeçare “Qazim Zenel Tepshi”, me rastin e 30-vjetorit të shpalljes së Parkut Natyror “Qafështamë” si zonë e mbrojtur. Gjatë aktivitetit u prezantuan vlerat natyrore të parkut, biodiversiteti i pasur, habitatet karakteristike si dhe rëndësia e burimeve ujore për ekosistemin. Nxënësit u njohën me florën, faunën dhe shpendët që jetojnë ose kalojnë në këtë zonë. Aktiviteti vijoi me punë kreative, ku nxënësit ngjyrosën figura të faunës dhe realizuan postera mjedisore në grupe, duke nxitur imagjinatën dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e natyrës.

16 janar 2026, orë mjedisore

Në atmosferën festive të fundvitit, specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Myrteza Hamit Pengili” në Krujë.

Nxënësit u njohën me Parkun Natyror të Qafështamës, vlerat e tij natyrore dhe rëndësinë e biodiversitetit, si dhe me rolin e maleve në ruajtjen e ekuilibrave natyrorë. Diskutimet u shoqëruan me shembuj praktikë dhe ndërveprim aktiv me nxënësit.

Në kuadër të krijimtarisë festive, fëmijët realizuan bredhin festiv, duke e trajtuar atë si simbol të natyrës së gjallë dhe të nevojës për mbrojtjen e saj. Aktiviteti u përmbyll me mesazhe pozitive mbi dashurinë dhe kujdesin ndaj mjedisit.

PN “Qafështamë” zonat të mbrojtura

ditë botërore shpendë



19 janar 2026, shpendët shtegtarë dhe jo shtegtarë

Njohja me shpendët shtegtarë dhe jo shtegtarë ishte në fokus të orës mjedisore të zhvilluar nga specialistët e AdZM Durrës me nxënësit e klasës VII të shkollës 9-vjeçare "Jubë". Gjatë aktivitetit u shpjeguan dallimet mes këtyre grupeve të shpendëve, përshtatjet e tyre për udhëtime të gjata dhe roli që kanë në ekosistem, si përhapja e farave dhe kontrolli i insekteve. Nxënësit u njohën gjithashtu me habitatet ku jetojnë zogjtë, si pyjet, ligatinat dhe zonat bregdetare, duke diskutuar mbi rëndësinë e ruajtjes së tyre dhe ndikimin që ka aktiviteti i njeriut në jetën e shpendëve..

“EDUKIMI MJEDISOR”, TIRANË



21 janar 2026, pyjet në dimër

Specialistët e AdZM Tiranë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 6-të të Shkollës 9-vjeçare “Tufinë”. Nxënësit u informuan mbi rëndësinë e pyjeve, sfidat që ato përballojnë gjatë dimrit dhe rolin e secilit për mbrojtjen e tyre. Aktiviteti u përmbyll me mbjelljen praktike të fidanëve të llojit Pishë e zezë, duke dhënë mesazhin: kujdesi dhe përgjegjësia ndaj natyrës janë detyrë e secilit.

26 janar 2026, Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

Nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Shën Gjergj” patën mundësinë të eksplorojnë nga afër bukuritë natyrore të Parkut Natyror “Mali me Gropa–Bizë–Martanesh” dhe të mësojnë rëndësinë e ruajtjes së burimeve ujore dhe mjedisit përreth. Rugëtimi përfundoi me një moment magjik pranë Ujëvarës, ku freskia dhe bukuria e natyrës i ftonin të vlerësonin më shumë kujdesin për ambientin.

31 janar 2026, Dita e Shpalljes së Parkut Natyror “Mali me Gropa–Bizë–Martanesh”

Në shkollën 9-vjeçare “Vesel Tila”, Shën Mëri, Shëngjergj, nxënësit e klasës së 6-të realizuan një aksion pastrimi përgjatë shtegut drejt Ujëvarës së Përroit të Kecit. Ata krijuan gjithashtu një poster dhe një maket të Malit me Gropa, duke theksuar mesazhin: përkushtimi ndaj natyrës dhe përgjegjësia qytetare janë themeli i mbrojtjes së mjedisit.

pyjet park natyror

orë mjedisore ditë botërore

“EDUKIMI MJEDISOR”, ELBASAN



23 janar 2026, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Elbasan njohën nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar "Sali Halili" Rrajcë me vlerat natyrore dhe mjedisore të Parkut Kombëtar "Shebenik". Gjatë kësaj ore mjedisore, nxënësit u informuan mbi florën dhe faunën e pasur dhe të larmishme të parkut, ndërsa aktiviteti u shoqërua me mesazhe ndërgjegjësuese dhe nxitje për të qenë qytetarë të përgjegjshëm ndaj mjedisit.

26 janar 2026, Dita Botërore e Edukimit Mjedor

Dita e Edukimit Mjedor na kujton rëndësinë e mbrojtjes së natyrës dhe të jetesës në harmoni me të. Përmes edukimit mjedor mësojmë të kujdesemi për ajrin, ujin, tokën dhe gjallesat që na rrethojnë. Çdo veprim i vogël, si riciklimi apo ruajtja e pastërtisë, kontribuon për një të ardhme më të shëndetshme për brezat e ardhshëm.

AdZM Elbasan i kushton një rëndësi të veçantë edukimit dhe ndërgjegjësimin të rinjve, duke zhvilluar orë mjedisore në shkolla me tematika dhe aktivitete të përgatitura nga specialistët. Në kuadër të kësaj dite, u realizua një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës 9-vjeçare "Kasem Zika", ku ata u njohën me vlerat natyrore të Parkut Kombëtar "Shebenik", si dhe me florën dhe faunën e pasur dhe të larmishme të këtij parku.

27 janar 2026, Dita e Shërbimit Pyjor

Në kuadër të Ditës së Shërbimit Pyjor, në Parkun Kombëtar të Shebenikut u mbollën 300 fidanë, një aktivitet që shërbeu si moment vlerësimi dhe reflektimi për rëndësinë e pyjeve. Në këtë iniciativë morën pjesë AdZM Elbasan, nxënës nga shkolla të ndryshme, organizata mjedisore dhe institucione lokale, të gjithë duke dhënë kontributin e tyre për mbrojtjen dhe pasurimin e pyjeve.

Parku Kombëtar "Shebenik" flora dhe fauna
edukim mjedor zona të mbrojtura

“EDUKIMI MJEDISOR”, FIER



27 janar 2026, Dita e Shërbimit Pyjor

Në kuadër të 103-vjetorit të Shërbimit Pyjor, AdZM Fier organizoi një aktivitet mjedisor mbjelljeje në Parkun Kombëtar Divjakë–Karavasta, në bashkëpunim me nxënësit dhe stafin pedagogjik të Shkollës Çermë–Sektor, Divjakë. Gjatë aktivitetit, nxënësit morën pjesë aktivisht për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, ruajtjen e biodiversitetit dhe vlerat natyrore të zonave të mbrojtura.



orë mjedisore shërbimi pyjor

park kombëtar

“EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS



Alpet e Shqipërisë habitate ditë botërore
zona të mbrojtura



21 janar 2026, fauna, flora dhe monumentet e natyrës

Specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Krumë”. Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me llojet kryesore të faunës dhe florës, vlerat natyrore dhe ekologjike të monumenteve të natyrës në zonën e Hasit, si dhe rëndësinë e mbrojtjes së tyre. Nxënësit morën pjesë në mënyrë interaktive dhe realizuan vizatime me tematikë mjedisore për të shprehur njohuritë e fituara.

26 janar 2026, Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

Në kuadër të Ditës Botërore të Edukimit Mjedisor, AdZM Kukës zhvilloi një orë mjedisore interaktive me nxënës të shkollës 9-vjeçare “Beslidhja e Malësisë”, Bashkia Tropojë. Nxënësit morën pjesë në prezantime, diskutime dhe shembuj praktikë mbi mbrojtjen e natyrës, promovimin e vlerave natyrore dhe biodiversitetit në Parkun Kombëtar Alpet e Shqipërisë, dhe edukimin mjedisor që në moshë të hershme.

27 janar 2026, Dita e Shërbimit Pyjor

Për të shënuar Ditën e Shërbimit Pyjor, specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një aktivitet ndërgjegjësues me nxënësit e Gjimnazit “Shishtavec”. Nxënësit u njohën me rolin dhe funksionet e shërbimit pyjor, si dhe me detyrat dhe mjetet e punës në pyje, përmes një situatë praktike të improvizuar në oborrin e shkollës. Aktiviteti synoi të rrisë ndërgjegjësimin për mbrojtjen e pyjeve dhe të nxisë përgjegjësinë qytetare ndaj mjedisit.

“EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇË



edukim mjedisor mbjellje fidanësh
zona të mbrojtura



9 janar 2026, vizitë me nxënësit

Specialistët e AdZM Korçë organizuan një vizitë me nxënësit e klasës 12 të “Preca College”, për t’i njohur me Parkun Kombëtar të Prespës dhe minoritetin maqedonas që jeton në zonë. Nxënësit morën informacion dhe u njohën me trashëgiminë kulturore dhe natyrore të Prespës, përmes dokumentimeve dhe ekspozitës “Minoriteti Maqedonas në Pustec, trashëgimi brez pas brezi”.

16 janar 2026, aksion pastrimi në plazhin e Zaroshkës

Specialistët e AdZM Korçë organizuan një aksion pastrimi pranë plazhit të Zaroshkës dhe ftuan nxënësit e shkollës “Dy Dëshmorët” Pustec të merrnin pjesë. Të rinjtë kontribuan aktivisht në heqjen e mbetjeve urbane, duke kuptuar rëndësinë e ruajtjes së mjedisit dhe rolin e tyre në mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit lokal.

18 janar 2026, Censusi i shpendëve në Pogradec

Nxënësit e klasës 12 të “Muharrem Çollaku” Pogradec morën pjesë në censusin e shpendëve dimërues pranë liqenit, ku panë nga afër dhe numëruan llojtë dhe individët e shpendëve. Aktiviteti u shndërrua në një eksperiencë praktike, ku të rinjtë mësuuan mbi biodiversitetin e zonës dhe rëndësinë e ruajtjes së shpendëve dhe habitatit të tyre natyror.

26 janar 2026, Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

Specialistët e AdZM Korçë organizuan orë mjedisore në shkollat "Sotir Gurra" dhe "Hamdi Alin", ku nxënësit u njohën me rëndësinë e ruajtjes së natyrës dhe biodiversitetit. Gjatë aktivitetit, u përdorën metoda interaktive dhe praktike, duke përfshirë personifikimin e elementeve natyrore dhe mbjelljen e fidanëve, me mesazhin: "Natyra nuk ka zë, por ka nevojë për veprimet tona".

27 janar 2026, Dita e Shërbimit Pyjor

Specialistët e AdZM Korçë organizuan aktivitetet mjedisore me nxënësit e gjimnazit "Gjergj Pekmezi", ku u mbollën 250 fidanë gështenja dhe qershi të egra me mesazhin: "Një pemë e mbjellë sot, një jetë më e shëndetshme nesër". Në Shkollën e Mesme "Avdulla Progri", Progër, nxënësit u njohën me rëndësinë e ruajtjes së pyjeve dhe rolin e tyre në mbrojtjen e natyrës, me mesazhin: "Të mbrojmë natyrën".

27 janar 2026, Dita e Shërbimit Pyjor

Pyjet janë mushkëritë e planetit dhe luajnë një rol jetik në ruajtjen e ekuilibrit natyror dhe jetës në Tokë. Specialistët e AdZM Korçë, nëpërmjet një ore mjedisore në shkollën e mesme "Avdulla Progri" (klasa 8), informuan dhe ndërgjegjësuuan nxënësit për rëndësinë e mbrojtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve, duke i nxitur të kujdesen më shumë për natyrën.

28 janar 2026, mbrojtja e mjedisit

Mjedisi është shtëpia jonë e përbashkët dhe mbrojtja e tij është përgjegjësi e secilit prej nesh. Specialistët e AdZM Korçë zhvilluan një orë mjedisore në shkollën "Stavri Themeli" (klasa 4), ku nxënësit krijuan postera edukues, dhanë mesazhe sensibilizuese dhe morën pjesë në një quiz për të forcuar njohuritë mbi kujdesin ndaj natyrës.

“EDUKIMI MJEDISOR”, VLORË



22 janar 2026, orë mjedisore mbi indikatorët mjedisorë

Indikatorët mjedisorë janë thelbësorë për të kuptuar gjendjen dhe ndryshimet në natyrë.

Specialistët e AdZM Vlorë zhvilluan një orë mjedisore me studentët e Universitetit “Ismail Qemali” (dega Biologji), ku i njohën me indikatorët mjedisorë dhe ndanë eksperiencë reale nga puna në zonat e mbrojtura, duke i afruar më shumë me praktikën në terren.

26 janar 2026, Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

Edukimi mjedisor është çelësi për të mbrojtur natyrën dhe pasuritë tona natyrore. Specialistët e AdZM Vlorë zhvilluan një orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare “Urani Rumbo”, ku nxënësit u njohën me vlerat e Parkut Natyror “Syri i Kaltër”, rëndësinë e biodiversitetit dhe nevojën për ruajtjen e burimeve ujore.

Parku Natyror “Syri i Kaltër” ndërgjegjësim
orë mjedisore